



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 215 / Prot.
13

Tiranë, më 05/05/2015

REKOMANDIM
Nr. 13 / datë 05/05/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, në ngarkim të kontrolluesit "**Unioni Shqiptar Kursim Kredi**" (USHKK),

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhrit nr. 40, datë 20/03/2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer inspektimi administrativ pranë kontrolluesit "**Unioni Shqiptar Kursim Kredi**" (USHKK), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së personave me initiale L.M dhe E.Ç (subjekte të të dhënave personale), drejtuar Zyrës së Komisionerit, në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe informacionit personal të tyre, nga kontrolluesi Unioni Shqiptar Kursim Kredi;
- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i neneve 5, 6, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe respektimi i të drejtave të kategorisë së subjekteve të të dhënave "klientë".

"**Unioni Shqiptar Kursim Kredi**" (USHKK) është bashkimi vullnetar i Shoqërive Kursim Kredi (SHKK), i krijuar më 25 Janar 2002 mbi bazën e ligjit për Shoqëritë Kursim Kredi dhe i licencuar nga Banka e Shqipërisë (licenca nr. 02, datë 09.08.2002). Gjatë aktivitetit të tij kontrolluesi përpunon të dhëna personale të kategorisë "klientë" (në cilësinë e subjekteve të të dhënave).

Kontrolluesi USHKK, në ushtrimin e veprimtarisë së tij mbështetet në ligjin nr. 8782, datë 03/05/2001 "Për shoqëritë e kursim kreditit", aktet nënligjore në këtë fushë, Rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për mbikëqyrjen e Shoqërive të Kursim Kreditit dhe Unioneve të tyre", Statutin si dhe aktet e brendshme rregullative që ai nxjerr.

Inspektimi administrativ u iniciua, mbi bazën e ankesave të paraqitura nga personat me initiale L.M dhe E.Ç (në cilësinë e ish punonjësve të USHKK), të cilët pretendonin se kontrolluesi USHKK, pas shkëputjes së marrëdhënieve të punës me ta vazhdon të mbajë të hapura adresat e tyre të e-mailit (adresa pune). Pala ankuese (nëpërmjet formularit të ankesës) pretendon se adresa e e-mailit është e dhënë personale dhe në këtë rast është shkelur ligji nr. 9887 datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

1. Lidhur me ankesën.

Palët ankuuese, për të mbështetur pretendimet e tyre, kanë paraqitur bashkëlidhur ankesës shkresën nr. 1095 prot, datë 11.03.2015, të USHKK-së, "Mbi përkatësisë individuale të adresave elektronike referuar adresave të e-mailit", e cila përmban adresat elektronike të punonjësve të USHKK.

Zyra e Komisionerit, bazuar në provat e administruara dhe deklaratimet e përfaqësuesit të kontrolluesit, konstaton se kontrolluesi aktualisht është në proces gjyqësor me palët ankuuese, për largimin e tyre nga puna dhe shkresa e paraqitur nga palët ankuuese si provë është nxjerrë nga kontrolluesi me qëllimin e administrimit si provë në gjykatë dhe i është siguruar edhe personave në fjalë.

Në ankesë, personi me initiale L.M ka pretenduar se i ka shkëputur marrëdhëniet e punës më datë 08.07.2013, ndërsa personi me initiale E.Ç ka pretenduar se i ka shkëputur marrëdhëniet e punës më datë 14.10.2013.

Zyra e Komisionerit ka verifikuar vërtetësinë e ekzistencës së marrëdhënies së punës midis ankuesve dhe kontrolluesit USHKK dhe ka administruar si provë fotokopjet e librezave të punës, nga të cilat rezulton se personi me initiale L.M i ka shkëputur marrëdhëniet e punës me kontrolluesin në datën e deklaruar prej tij (08.07.2013), ndërsa personi me initiale E.Ç, në datën 21.10.2013.

Lidhur me pretendimet se adresat e e-maileve ishin të hapura, u kryen verifikimet përkatëse në sistemin elektronik (mail-server) të administruar nga kontrolluesi dhe u siguruan provat shkresore përkatëse. Në këtë kuadër, në cilësinë e provës u administruan shkresat zyrtare të brendshme, nëpërmjet të cilave Drejtoria e Burimeve Njerëzore i drejtohet Sektorit IT për të bllokuar aksesin e palëve ankuuese në kompjutera, rrjet, internet dhe e-mail. Zyra e Komisionerit pas verifikimeve në mail-server konstaton se adresat e e-maileve të palëve ankuuese ishin të çaktivizuara, për personin me initiale L.M që prej datës 7.07.2013, ndërsa për personin me initiale E.Ç që prej datës 11.10.2013. Ky konstatim provohet nëpërmjet print-screen të sistemit të administruar në dosjen e inspektimit.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit konstaton se edhe pas çaktivizimit të tyre, email-et që dërgohen drejt këtyre adresave grumbullohen në ndërfaqen "bad queue" të mail-serverit. Në këtë kuadër Zyra e Komisionerit vlerëson se kjo mënyrë përpunimi krijon mundësi për leximin ose transferimin e e-maileve në një adresë tjetër.

Me qëllim shmangien e shkeljeve të mundshme, Zyra e Komisionerit kërkoi dhe monitoroi fshirjen e të gjitha mesazheve të mbledhura në ndërfaqen "bad queue" të mail-serverit, pas datës së shkëputjes së marrëdhënies të punës me palët ankuuese. Në këtë kuadër janë administruar në cilësinë e provës, *printscreen-et* e ndërfaqes "menaxhimi i llogarive", të *log-eve* të mail-serverit dhe ndërfaqes "bad queue" në programin *MailDaemon*.

Në vazhdim të seancës dëgjimore të datës 17.04.2015, përfaqësuesit e kontrolluesit kanë paraqitur pretendimet me shkresën nr. 1667 prot, datë 17.04.2015. Seanca dëgjimore është realizuar nga Zyra e Komisionerit në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë".

Nëpërmjet saj kontrolluesi thekson se llogaritë (e-maillet) e palëve ankuese nuk mund të fshihen pasi ndaj tyre janë të hapura procese ligjore (gjyqësore civile dhe penale) dhe e-maillet përbëjnë dhe administrohen në cilësinë e provës gjatë shqyrtimit gjyqësor. Pretendimet mbështeten në provat materiale si vijon: 1) Procesverbal i takimit, të datës 14.10.2013, të përfaqësuesve të kontrolluesit (në cilësinë e punëdhënësit) me palën ankuese E.Ç për njoftimin e arsyeve për zgjidhjen e kontratës së punës, në përputhje me Kodin e Punës (neni 144); 2) Vërtetim i Gjykatës së Rrethit Tiranë për gjykimin e çështjes civile me palë paditëse E.Ç dhe i paditur USHKK; 3) Njoftim për zgjidhjen e kontratës individuale të punës me palën ankuese E.Ç (nr. 4925 prot, datë 18.10.2013); 4) Printim i publikimit të çështjes gjyqësore në faqen online të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, si dhe prova të tjera të tjera (për të dyja palët ankuese) në mbështetje të pretendimeve të tyre.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se të dhënat personale të administruara nëpërmjet e-maileve të palëve ankuese, deri në datën e largimit të tyre nga puna, përpunohen në përputhje me nenin 5/1/d të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Përpunimi i këtyre të dhënave legjitimohet për sa kohë, ekziston qëllimi. Në rastin konkret, qëllimi i përpunimit është administrimi i tyre në cilësinë e provës gjatë proceseve gjyqësore civile dhe penale. Me përfundimin e proceseve gjyqësore ndaj palëve ankuese, përfundon edhe qëllimi i përpunimit të të dhënave dhe në këtë kuadër duhet të bëhet edhe fshirja e adresave të e-maileve dhe mesazheve përkatëse.

2. Lidhur me zbatimin e neneve 5, 6, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar dhe respektimit të të drejtave të kategorisë së subjekteve të të dhënave “klientë”

a) Kontrolluesi “*Unioni Shqiptar Kursim-Kredi*”, mbledh dhe përpunon të dhëna personale të subjekteve të të dhënave/klientë (emrin, mbiemrin, atësinë, datëlindjen, vendlindjen, numrin e telefonit, gjendjen civile, profesionin, statusin dhe gjendjen financiare të kredimartjes në institucione financiare), nëpërmjet oficerëve të kredive (punonjës të saj) që funksionojnë pranë çdo SHKK-je, me qëllim aksesimin pranë Regjistrit të Kredive, administruar nga Banka e Shqipërisë, për të nxjerrë “Raportin e kredisë” për subjektet e të dhënave.

Regjistri i Kredive përbën bazën elektronike të të dhënave identifikuese dhe financiare të personave (ekspozimet kreditore të tyre në sistemin bankar dhe/ose financiar), që aplikojnë për kredi pranë një banke, dege të një banke të huaj të licencuar nga Banka e Shqipërisë apo pranë institucioneve të tjera kredidhënëse. Autoriteti përgjegjës për administrimin e sistemit të Regjistrit të Kredive është Banka e Shqipërisë, e cila përcakton dhe aksesin e institucioneve kredidhënëse në këtë regjistër. Institucioni kredidhënës i paraqet Bankës së Shqipërisë një kërkesë ku kërkohet miratimi i aksesit në regjistër për një punonjës të saj. Akesi i sigurt realizohet përmes lëshimit nga BSH të një çertifikate elektronike që instalohet në kompjuterin nga i cili do aksesohet ky regjistër. Kjo çertifikatë përmban të dhëna mbi personin (operatorin) të cilit i është lëshuar, institucionin kredidhënës që ai përfaqëson dhe periudhën e vlefshmërisë të saj.

Nga hetimi administrativ rezultoi se procesi i aksesit në Regjistrin e Kredive bëhet pa verifikuar paraprakisht marrjen e pëlqimit nga ana e subjektit të të dhënave (klientit). Në email-in që operatori financiar i kontrolluesit i dërgon personit që do kryej kontrollin në regjistër, shënohen vetëm të dhënat identifikuese të klientit emër/mbiemër numër letërnjoftimi dhe nuk bashkëngjitet klauzola e pëlqimit paraprak e as karta e identitetit të klientit/anëtarit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, pavarësisht faktit se pëlqimi merret në momentin e nënshkrimit të formatit të "Aplikimit për Kredi" (në prani të oficerit të kredisë), mosverifikimi i pëlqimit gjatë procesit të aksesit në Regjistrin e Kredive nga ana e "përdoruesve të autorizuar", krijon hapësirë për shkelje të dispozitave ligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale. Konkretisht kjo praktikë vjen në kundërshtim me nenin 5 (pika 1, shkronja a dhe ç) dhe nenin 6, pika 1/a të ligjit, (Kreu II "Përpunimi i të dhënave personale", në të cilin parashikohen parimet e përpunimit të të dhënave personale).

Përfaqësuesi i kontrollusit, nëpërmjet procesverbalit të inspektimit (datë 30.03.2015) parashtrori këto pretendime: "1. Përsa i përket pikës së parë në lidhje me verifikimin e pëlqimit paraprak të klientit gjatë procesit të aksesimit në Regjistrin e Kredive, inspektorëve ju paraqit e përshkruar procedura që ndiqet në rastin e marrjes së pëlqimit të klientit e cila është formalizuar nëpërmjet përfaqësuesit të Unionit në SHKK (oficerit të kredisë)". Pikërisht ky punonjës merr pëlqimin e klientit dhe pasi bindet (nëpërmjet nënshkrimit para syve të tij) ia përcjell personave kompetent në union për të bërë verifikimin; 2. Përpunimi i të dhënave personale bëhet bazuar në kriteret ligjore sipas Nenit 5, në mënyrë të ndershme, të ligjshme, në formën e caktuar dhe në përputhje me qëllimin, si dhe duke u bazuar në pëlqimin paraprak të klientit që është baza e përpunimit si dhe në zbatim të kriterëve të tjera sipas nenit 6 të ligjit".

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit vlerëson se është e nevojshme që të ndryshojë procedura e verifikimit të pëlqimit, e cila duhet të kryhet edhe nga personat që aksesojnë në Regjistrin e Kredisë. Kjo me qëllim shmangien e abuzimeve dhe shkeljeve të mundshme të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe për shkak se në kuadër të informacionit personal, aksesin të të dhënave personale në Regjistrin e Kredive dhe marrjen e informacionit e realizon USHKK. Ky i fundit mbetet inaktiv nëse nuk i vihet në dispozicion një informacion i tillë. Moskryerja e verifikimit çënon potencialisht dhe praktikisht parimet e sanksionuara në ligjin nr. 9887. Zyra e Komisionerit ka patur raste në të cilat, praktika të tilla, kanë sjellë abuzime me të dhënave personale.

b) Kontrolluesi USHKK, ka hartuar rregullore të brendshme lidhur me politikën dhe procedurat e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Pjesë e kësaj rregullore janë:

- Siguria fizike si dhe mbrojtja e serverëve dhe kompjuterëve nga përdorimi i personave të paautorizuar;
- Mbrojtja me antivirus dhe fjalëkalim e kompjuterëve dhe sistemeve të shërbimit ndaj klientit;
- Krijimi i backup-eve të të dhënave;
- Administrimi i incidenteve të teknologjisë së informacionit;
- Përdorimi i shërbimit të Internetit dhe Email.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pavarësisht faktit se kontrolluesi ka rregullore sektoriale sipas departamenteve përkatëse (të cilat parashikojnë edhe disa rregulla mbi administrimin e të dhënave), është e nevojshme që të hartohet një Rregullore e Brendshme për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale", në zbatim të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", bazuar në formatin tip të publikuar në faqen e Zyrës së Komisionerit. Hartimi i kësaj rregulloreje do të konsolidonte praktikën e përpunimit të të dhënave personale, duke garantuar respektimin e plotë të ligjit. Gjithashtu, është e domosdoshme dhe për shkak të sasisë së madhe të informacionit personal që përpunohet nga kontrolluesi duke qenë se ka në përbërje disa Shoqëri Kursim Kredi dhe një numër të konsiderueshëm subjektësh të të dhënave personale (klientë, anëtarë).

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 5, 6, 27, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 5 pika 1/b/d të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar:
 - a) Të realizohet fshirja e adresave të e-maileve dhe mesazheve përkatëse pas përfundimit të proceseve gjyqësore ndaj palëve ankuese, pasi përfundon edhe qëllimi i përpunimit të të dhënave;
 - b) Të zbatohen masa teknike që pengojnë mbledhjen e mëtejshme në mail-server, të mesazheve që dërgohen drejt adresave e-mail të subjekteve që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me kontrolluesin;
 - c) Të fshihen nga mail-serveri llogaritë e ç'aktivizuara e-mail të subjekteve të të dhënave që nuk janë më aktiv, në rast se nuk ka qëllim të ligjshëm për përpunimin e mëtejshëm.
2. Në zbatim të nenit 5, pika 1, shkronja a) dhe ç) dhe nenin 6, pika 1/a të ligjit, (Kreu II "Përpunimi i të dhënave personale", në të cilin parashikohen parimet e përpunimit të të dhënave personale), përpara aksesimit të Regjistrit të Kredive të kryhet verifikimi i marrjes së pëlqimit për secilin subjekt të të dhënave personale (klient).
3. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të hartohet një Rregullore e Brendshme për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale", sipas formatit tip të publikuar në faqen e Zyrës së Komisionerit, www.idp.al.
4. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga data e njoftimit të këtij rekomandimi.
5. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, pas plotësimit të këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë, për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

